



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 199  
Datë: 7 / 2 / 2025

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në nenin 20 pika 2, nën-pika 2.2 dhe në zbatim të nenit 98 dhe 99 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.01.2025, mori këtë:

**V E N D I M**

- I.** Obligohen të gjitha njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës, të cilat kanë të akredituar programet e studimeve baçelor dhe master, duke i përfshirë edhe ato programe që janë në proces të akreditimit, t'i dërgojnë propozimet në Rektorat, për kuotat e përgjithshme (numrin e kandidatëve) që do të pranohen në vitin akademik 2025/26 dhe atë më së largu deri më 31 mars 2025.
- II.** Përjashtimisht, nga pika I e këtij vendimi, bëhet në ato njësi akademike, në të cilat ende nuk ka përfunduar procesi i akreditimit ose eventualisht nëse procesi i akreditimit nga AKA-ja zgjatet deri para realizimit të procedurave për shpalljen e konkursit.
- III.** Afatet për realizimin e procedurës së konkursit të parë për pranimin e studentëve në nivelin baçelor dhe master për vitin akademik 2025/26, realizohen sipas dinamikës si në vijim:
  - a) Senati i UP-së, sipas propozimeve të njërive akademike gjatë muajit maj 2025 miraton konkursin dhe kriteret për përzgjedhjen e studentëve në të dy nivelet e studimeve, atë baçelor dhe master, për vitin akademik 2025/26.
  - b) Konkursi për vitin akademik 2025/26, për studimet e nivelit baçelor, do të publikohet me datë 30 qershor 2025 deri më 8 korrik 2025.  
Ndërsa për nivelin master do të publikohet me datë 30 qershor 2025 deri më 11 korrik 2025.
  - c) Provimet pranuese në nivelin baçelor, do të organizohen nga data 10, 11 dhe 12 korrik 2025.  
Ndërsa për nivelin master do të organizohen me datë 14 dhe 15 korrik 2025.
  - d) Rezultatet preliminare të kandidatëve baçelor do të shpallen me datë 13 korrik 2025.  
Ndërsa për kandidatët e nivelit master me datë 16 korrik 2025.
  - e) Afati i ankesave për kandidatët e nivelit baçelor do të jetë me datë 14 dhe 15 korrik 2025.  
Ndërsa për nivelin maser afati i ankesave do të jetë me datë 17 dhe 18 korrik 2025.
  - f) Rezultatet përfundimtare të kandidatëve në nivelin baçelor do të publikohen me datë 16 korrik 2025.  
Ndërsa për kandidatët e nivelit master do të publikohen me datë 19 korrik 2025.
  - g) Kandidatët e pranuar në nivelin baçelor, për vitin akademik 2025/26, do të regjistrohen në administratë qendrore nga data 21 korrik deri më 31 korrik 2025.  
Ndërsa kandidatët e pranuar në nivelin master do të regjistrohen nga data 25 deri më 29 gusht 2025.

- h) Konkursi plotësues për vitin akademik 2025/26, për studimet e nivelit baçelor dhe master, do të publikohet me datë 3 shtator 2025 deri më 10 shtator 2025.
- i) Provimet pranuese në nivelin baçelor dhe master, do të organizohen me datë 11 dhe 12 shtator 2025.

IV. Obligohen njësitë akademike dhe zyrat përkatëse për regjistrimin e studentëve që të respektojnë afatet dhe planin dinamik të përcaktuar si në pikat I dhe III të këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

### A r s y e t i m

Senati i Universiteti të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.1.2025, duke iu referuar nenit 20 pika 2, nën-pika 2.2 dhe në zbatim të nenit 98 dhe 99 të Statutit të UP-së, me arsyetimin që ato njësi akademike që kanë të akredituar programet e studimeve të nivelit baçelor dhe master të sjellin propozimet për numrin e studentëve, në mënyrë që Senati i UP-së të shqyrtojë me kohë dhe të mund të përgatitë konkursin sipas propozimeve të njësive akademike më së largu deri më 31 mars 2025, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. E tëra kjo më qëllim të organizimit - zhvillimit të procedurave të konkursit për studimet e lartcekura, duke përfshirë periudhën e miratimit të propozimeve për numrin e studentëve, hapjen e konkursit, mbajtjen e provimeve pranuese, shqyrtimin e ankesave, shpalljen e rezultateve përfundimtare e deri te regjistrimi i kandidatëve të pranuar, për të cilat kandidatët e pranuar në këto studime të kenë mundësinë e fillimit të vitit akademik sipas nenit 97 të Statutit të UP-së, konkretisht më 15 shtator 2025. Prandaj nga ajo që u tha më lart dhe mbi këtë bazë, Senati i UP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Njësive akademike të UP-së;
3. Zyrës Ligjore;
4. Zyrës për Çështje Akademike;
5. Zyrës për çështje të studentëve.



Kryesuesi i Senati të UP-së

*Arben Hajrullahu*  
Prof. Arben Hajrullahu, Rektor